



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 6

Prishtinë, më 27 prill 2011, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Sasha Gjokiq, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Lejla Selimi – OSBE, Natyra Kasumaj – KDI dhe Ervin Ibrahim - UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13. 04. 2011;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social, para miratimit në parim;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për organizimin sindikal, para miratimit në parim;**
- 5. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 13. 04. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së 13 prillit 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin Ekonomik-Social, para miratimit në parim

Fikrim Damka - Tha se Projektligji ka ardhur nëpërmjet strategjisë legislative të Qeverisë. Ne duhet ta shqyrtojmë në parim dhe t'i rekomandojmë Kuvendit ta miratojë ose eventualisht të mos e miratojë në parim. Hap diskutimin për këtë Projektligj.

Flora Brovina – Vuri në pah ky Projektligj ka qenë edhe më herët në Kuvend. Komisioni i mandatit të kaluar ka insistuar së pari të miratohen Ligji i punës dhe Ligji për organizimin sindikal etj. Ndoshta duhet ta organizojmë edhe një tryezë, në të cilën do të diskutohet rreth rolit të Këshillit Ekonomik Social. Na pret punë e madhe në vazhdim rreth këtij Projektligji. Është një projektligj që meriton të miratohet në parim.

Aurora Bakalli - Kishte një vërejtje sa i takon këtij Projektligji. Kur flitet për përfaqësuesit në këtë Këshill, mendon se duhet të ketë anëtarë edhe përfaqësues edhe nga shoqëria civile.

Salihe Mustafa - Në këtë Projektligj thuhet se kryesuesi i këtij Këshilli, në vitin e parë, do të jetë ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ndërkaq dihet se mandati është 4-vjeçar.

Nazane Breca - Mendon se Projektligji duhet të miratohet në parim.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri u pajtua t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë në parim Projektligjin për Këshillin Ekonomik-Social.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për organizimin sindikal, para miratimit në parim

Time Kadriaj - Mendon se ky Projektligj duhet të miratohet në parim.

Bahri Thaçi – Theksoi se ky Projektligj është shumë i rëndësishëm dhe duhet të miratohet në parim. Në vazhdim duhet të përpiqemi shumë që Projektligj të punohet në mënyrën më të mirë.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri u pajtua t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë në parim Projektligjin për organizimin sindikal.

5. Të ndryshme

Time Kadriaj - Sot, grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin, kemi pasur takim me sekretarin permanent të MSH-së, me drejtorin e Zyrës Ligjore dhe me kryeinspektorin shëndetësor. Më vonë do të përgatisim raport lidhur me këtë çështje.

Salihe Mustafa - Kishte një vërejtje. E kemi formuar një grup pune për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin, por nuk e caktuam kush do ta udhëheqë atë grup. Në mbledhjen e parë të këtij grupi, në planin e punës, vërejtja se udhëheqëse është kolegja,

Time Kadriaj. Pasi e konsultova Rregulloren e punës, e pashë se Komisioni duhet ta zgjedhë kryesuesin. Kërkoj të mos shkelen procedurat dhe në të ardhmen të harmonizohemi më mirë.

Time Kadriaj - Më ka propozuar kryetari dhe të gjithë jemi pajtuar për një gjë të tillë.

Salihe Mustafa - Të mos keqkuptohemi. Me sa e di, nuk kemi diskutuar për një gjë të tillë.

Gëzim Kelmendi - Propozoj që Komisioni t’ia dërgojë Ministrisë së Arsimit një rekomandim që ta fusë në Ligjin për arsim masën ndëshkimore, për ata që nuk e respektojnë Ligjin për duhanin. U dha këtu ideja e rritjes së akcizës për duhanin dhe do të ishte mirë që mjetet e grumbulluara të alokohen në Ministri të Shëndetësisë për programet dhe planet edukative për ndalimin e pirjes së duhanit.

Flora Brovina - Për këtë çështje është mirë të vizitohet Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.

Nazan Breca - Instituti duhet t’i koordinojë aktivitetet në këtë drejtim me komunat dhe t’i delegojë disa përgjegjësi nëpër komuna.

Bahri Thaçi - Aktivitetet e tilla duhet të bëhen për çdo ditë dhe jo vetëm në formë fushate. I propozuam sekretarit që për këtë të angazhohen edhe komunat.

Aurora Bakalli - Jam e interesuar të di ku jemi sa i përket çështjes së barërave dhe cili është qëndrimi i Komisionit lidhur me këtë çështje, sepse për këtë punë i kemi pasur të ftuar edhe përfaqësuesit nga Shoqata Farmaceutike, Dogana dhe AKPM-ja.

Fikrim Damka - Për çështjen e barërave kemi planifikuar ta ftojme ministrin në Komision dhe të diskutojmë me të edhe për çështje të tjera. Besojmë se javën tjetër do t’i kemi ministrin dhe drejtorin e AKPM-së në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka